



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE

BORDI

VENDIM

Nr.34, Datë 21.02.2020

MBI

**MODIFIKIMIN E ANEKSIT TË LICENCËS SË SHOQËRISË “HEC-I BISHNICA 1,2”  
SH.P.K., NR. 95, SERIA PV10K, DHËNË ME VENDIMIN E BORDIT TË  
KOMISIONERËVE TË ERE-S NR.23, DATË 23.03.2010, PËR LICENSIMIN E SHOQËRISË  
“HEC-i BISHNICA 1,2” SH.P.K.**

Në mbështetje të neneve 16, nenit 37 pika 2, gërma” a” dhe nenit 43 të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, neneve 9, pika 1, gërma “a”, “b”, “c”, dhe nenit 15 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s Nr. 109, datë 29.06.2016, i ndryshuar, si dhe nenit 15 të “Rregullores të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin Nr. 96 datë 17.06.2016, Bordi i ERE, në mbledhjen e tij të datës 21.02.2020, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes me nr.30/6 Prot, datë, 12.02.2020, “Për modifikimin e licencës së shoqërisë “Hec-i Bishnica 1,2” sh.p.k., nr. 95, seria pv10k, dhënë me vendimin e bordit të komisionerëve të ERE-s nr.23, datë 23.03.2010, për prodhimin e energjisë elektrike, për një afat 30-vjeçar”,

**Konstatoi se:**

- Me shkresën protokolluar në ERE nr. 738 prot., datë 13.11.2019, shoqëria ka paraqitur në ERE kërkesën për modifikim licence.
- Shoqëria “HEC-i Bishnica 1, 2” sh.p.k., është mbajtëse e licencës nr. 95, Seria pv10k, dhënë me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s Nr. 23, datë 23.03.2010, për prodhimin e energjisë elektrike, për një afat 30-vjeçar.
- Bordi i ERE-s, me vendimin Nr. 14, datë 23.01.2020, filloi procedurën për modifikimin e licencës nr. 95, Seria PV10K, dhënë shoqërisë “HEC-i BISHNICA 1,2” sh.p.k., me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s Nr. 23, datë 23.03.2010, i cili konsistonte në ndryshimin e njësive gjeneruese:
  - Numri i njësive gjeneruese: Është: 2 (njësi), me kapacitet të instaluar 2.5 MW.  
Bëhet 3 (njësi), me kapacitet të instaluar 2.5 MW.
- Në vijim të vendimit të bordit të ERE-s Nr. 14, datë 23.01.2020, u krye njoftimi në median e shkruar dhe në përfundim të afatit të përcaktuar në rregullore nuk rezultoi të ketë vërejtje apo ankesa nga palët e treta.

- Me shkresën protokolluar në ERE me nr. 389/1 Prot, datë 05.02.2020, shoqëria ka plotësuar dokumentacionin e konstatuar të munguar.
- Aplikimi i shoqërisë “HEC-i BISHNICA 1,2” sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” si më poshtë:
  - Neni 15, pika 4, gërma a: Informacioni me shkrim ku janë shpjeguar arsyet e kërkesës për modifikimin e licencës : Plotësuar. Shoqëria deklaron se shtimi i agregatit është vendosur për arsye të vështirësisë që ka hasur HEC-i në plotësimin e detyrimeve kontraktuale për prodhimin e energjisë elektrike.
  - Neni 15, pika 4, gërma b: Vendimi me shkrim i organeve drejtuese të të licensuarit të cilat shprehin vullnetin për të kërkuar modifikim licence : Plotësuar. Me shkresën nr. 389/1 Prot, datë 05.02.2020, shoqëria ka depozituar në ERE Vendimin e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë “HEC-i Bishnica 1,2” sh.p.k., të datës 05.02.2020, ku është vendosur të miratohet shtesa e një agregati të ri.
  - Neni 15, pika 4, gërma c: Miratimi i modifikimit të parametrave dhe kushteve të tjera të licencës kur këto janë të kushtëzuara me miratimin nga organe të tjera : Plotësuar. Shoqëria ka depozituar në ERE shkresën e MIE-s nr. 10416/3 Prot, datë 24.09.2018, në të cilën citohet se AKBN-ja e ka vlerësuar të pranueshëm vendosjen nga ana e shoqërisë të një agregati shtesë në hidrocentralin “Bishnica 2”, sipas kushteve të cituara në shkresën e AKBN-së nr. 6740/1 prot., datë 30.08.2019.
  - Neni 15, pika 4, gërma d: Ndikimet e pritshme të modifikimit të licencës ndaj detyrimeve të të licensuarit sipas legjislacionit në fuqi : Plotësuar. Shoqëria ka deklaruar se vendosja e këtij agregati shërben për të optimizuar skemën me qëllim realizimin e prodhimit të energjisë elektrike siç parashikuar në kontratën e koncesionit dhe për të shfrytëzuar funksionimin e tij në rastin e periudhave me prurje të ulëta.
  - Neni 15, pika 4, gërma e: Të ketë plotësuar pagesat e rregullimit në ERE. Plotësuar. Rezulton se shoqëria nuk është debitore sa i përket pagesave të rregullimit në ERE.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

#### **Vendosi :**

1. Modifikimin e Aneksit të licencës nr. 95, Seria PV10K, të shoqërisë “HEC-i Bishnica 1, 2” sh.p.k., miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s Nr. 23, datë 23.03.2010, për prodhimin e energjisë elektrike, me ndryshimin si më poshtë:

- Numri i njërive gjeneruese: Ishte: 2 (njësi), me kapacitet të instaluar 2,5 MW.  
Bëhet: 3 (njësi), me kapacitet të instaluar 2,5 MW.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet në ERE rishikim brënda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brënda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare

**KRYETARI I ERE**

**Petrit AHMETI**